

**Drejtuar: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

**Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura**

**Objekti:** Qëndrimi i 48 organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të institucioneve kërkimore-mësimore pas takimit të organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit mbi draft-vendimin e KM për Sistemin e Rivlerësuar të Zonave të Mbrojtura

Të nderuar,

Në vijim të ftesës suaj për hapjen e konsultimit mbi draft-vendimet e Këshillit të Ministrave për Sistemin e rivlerësuar të Zonave të Mbrojtura, ne, përfaqësuesit e 48 organizatave të shoqërisë civile dhe të institucioneve kërkimore-mësimore, pas pjesëmarrjes në takimin e datës 28.07.2021, në Tiranë, po ju përcjellim me anë të kësaj shkrese qëndrimin tonë të konsoliduar me shkrim, si vijon.

Sikurse u deklarua edhe gjatë fjalës sonë në takimin e mësipërm, 48 organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve kërkimore-mësimore të vendit, theksojnë një zëri se takimi i organizuar në datë 28.07.2021 është në kundërshtim të hapur me të gjitha kriteret ligjore për të qenë një konsultim publik, duke qenë se i gjithë procesi u parapri nga mangësi të theksuara, të cilat cenojnë diskutimet dhe vendimmarrjen përfundimtare për këtë çështje shumë të rëndësishme dhe tepër të ndjeshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Zonat e mbrojtura janë pasuri kombëtare dhe vendimmarrja për këto zona duhet t'i nënshtrohet kuadrit ligjor në fushën e planifikimit të territorit, ligjit për zonat e mbrojtura, ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit, ligjin për mbrojtjen e mjedisit, si dhe ligjeve të tjera në fusha specifike. Si subjekte me ndjeshmëri të lartë ndaj çështjeve mjedisore, konstatojmë një anashkalim të dispozitave ligjore dhe një mungesë transparence në vendimmarrje. Për këtë arsye, ne vijojmë të kemi paqartësi të shumta për këtë proces, jo vetëm për mënyrën se si po zhvillohet procesi i këshillimit, por edhe të anës përmbajtësore të vendimeve dhe ndikimeve që kjo vendimmarrje do të ketë në sistemin e zonave të mbrojtura dhe larminë biologjike në Shqipëri.

Kanë qene pikërisht synimi për të qartësuar këto pikëpyetje dhe dilema që na shtyu së pari që në datë 27.07.2021, t'i përcjellim Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet postës elektronike, një listë me pyetje dhe kërkesa procedurale për informacion dhe dokumentacion për këtë proces. Takimi na ndihmoi të hedhim dritë në këto pikëpyetje dhe të forcojmë bindjen tonë se ky proces është ndërtuar në paligjshmëri. Në vijim, po listojmë disa prej konstatimeve tona:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka propozuar miratimin e 53 VKM-ve lidhur me Zonat e Mbrojtura. Publikimi i draft VKM-ve nuk shoqërohet me asnjë dokument sqarues, por vetëm me emërtimin e zonës dhe hartën. Gjithashtu hartat e dhëna janë harta memece sepse nuk të lejojnë të kuptosh vendosjen në terren të kufijve të zonave të mbrojtura dhe të nënzonave të propozuara për cdo zonë të mbrojtur. Kjo na ka vënë në një pamundësi reale për të bërë një vlerësim profesional të ndryshimeve që po ndodhin dhe arsyeve mjedisore, biologjike, ekologjike, ligjore, teknike, që sjellin nevojën për këto ndryshime.

2. Çdo ndryshim në secilën prej zonave të mbrojtura duhet të kryhet në përputhje me Planin Specifik të Zonave të Mbrojtura. Kjo parashikohet në disa dispozita të ligjit 81/2017 “*Për zonat e mbrojtura*” (nenet 5, 10, 12, etj..) Më konkretisht, shpallja e ZM-ve, heqja e tyre dhe ndryshimi i sipërfaqes së ZM-ve, duhet të paraprihet nga hartimi i Planit Specifik të tërësisë së zonave të mbrojtura si një dokument që specifikon planifikimin, bashkërendimin dhe drejtimin për ngritjen e sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore.

Neni 5, pika 5 e ligjit për ZM, i kërkon Ministrisë përkatëse të mjedisit, hartimin e Planit specifik në përputhje me dokumentin e politikave strategjike të mbrojtjes së biodiversitetit, miratimin e tij me urdhër të ministrit dhe publikimin e Planit Specifik në Fletoren Zyrtare.

3. Draft Vendimet e Këshillit të Ministrave janë rezultat i një procedure e cila nuk respekton një sërë parashikimesh të detyrueshme të ligjit për zonat e mbrojtura. Më konkretisht lidhur me shtimin e zonave të reja të mbrojtura, **mungojnë**:
  - a. Mendimet e institucioneve akademike dhe shkencore të detajuara dhe të mëvetshme për secilin projekt-vendim.
  - b. Mendimet me shkrim të secilës prej bashkive brenda dhe rreth zonave të propozuara për secilin projekt-vendim.
  - c. Vlerësimi i ndikimit në mjedis, duke përfshirë identifikimin e proceseve dhe të kategorive të veprimtarive, të cilat mund ta kërcënojnë diversitetin biologjik dhe attribute të tjera të vendit të propozuar, përfshirë zonat përreth, për secilën projekt VKM.
  - d. Vëzhgimi i ndikimit social dhe ekonomik të popullatës vendore për secilin projekt-vendim, që përfshin situatën e përdorimit të territorit të propozuar dhe ndikimin e mundshëm të zonës së mbrojtur në këto përdorime.
  - e. Përshkrimi i masave kompensuese që mund të nevojiten të merren për të adresuar transferimin e pronësisë dhe të të drejtave për përdorimin e elementeve të diversitetit biologjik për secilin projekt-vendim.
  - f. Përshkrimi i masave zbutëse për secilin projekt-vendim.
2. Procesi i vendimmarrjes nuk është në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 35 “Heqja dhe ndryshimi i statusit të zonës së mbrojtur” të ligjit 81/2017 “*Për zonat e mbrojtura*”. Më konkretisht **mungojnë**:
  - a. Mendimet e institucioneve kërkimore-shkencore për secilin projekt-vendim.
  - b. Argumentimi për heqjen e statusit për secilin projekt-vendim.
3. Procesi i vendimmarrjes nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 36 “*Ndryshimi i sipërfaqes*” të ligjit 81/2017 “*Për zonat e mbrojtura*”. Më konkretisht **mungojnë**:
  - a. Argumentimi i nevojës së ndryshimit konkret të zonës së mbrojtur dhe arsytimi se si ky ndryshim do të përmirësojë rritjen dhe mbrojtjen e zonës pas vendimit të KKT-së për ndryshimin e sipërfaqes të secilës zonë të mbrojtur mjedisore.
  - b. Këshillimi me institucionet shkencore, me organet e qeverisjes vendore ku shtrihet zona.
4. Procesi i vendimmarrjes nuk është në përputhje as me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.994, datë 2.7.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”, të ndryshuar. Më konkretisht:

- a. Këshillimi duhet të përputhet me parashikimet e Kreut II “Pjesëmarrja e publikut të ndikuar në hartimin e politikave, të strategjive dhe planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin”. Në këtë kuadër ju kërkohet të garantoni shpalljen e vazhdueshme të vendimeve për 30 ditë sikurse parashikuar në pikën 4 të këtij kreu.
- b. Procesi i vendimmarrjes nuk është në përputhje me Kreun III “Pjesëmarrja e publikut gjatë përgatitjes së projektakteve normative për mjedisin”, i cili kërkon vënien paraprake në dispozicion të publikut të relacionit përkatës për çdo projekt-vendim të parashikuar për t’u këshilluar. Ky relacion jo vetëm që nuk është publikuar po dhe nuk është përcjellë tek organizatat pjesëmarrëse. Sikurse u pranua dhe nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në takimin e datës 28 Korrik 2021, relacionet nuk janë përgatitur ende.
- c. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kreu këshillimin më 28.07.2021 ose 9 ditë kalendrike nga data e dërgimit të projektaktave për njohje. Pika 2/b e kreut III të VKM-se 994/2008, të ndryshuar, kërkon respektimin e afatit kohor prej jo më pak se 10 ditësh kalendrike nga data e dërgimit të projektaktit për njohje.

Së dyti, përveç aspekteve procedurale, vetë vendimmarrja do të shkaktojë pasoja të forta negative në Sistemin e Zonave të Mbrojtura dhe në larminë biologjike të vendit. Vendimmarrja prek më së tepërmi zonat e mbrojtura ligatinore që përfaqësojnë dhe hapësirën më të rëndësishme për larminë biologjike në Shqipëri.

Ne jemi të sigurtë se finalizimi i vendimmarrjes për Draft Vendimet e Këshillit të Ministrave do të shkaktojë:

- a. Cënim të integritetit ekologjik të thujse çdo ZM-je ligatinore bregdetare me pasojë reduktimin dhe përkeqësimin e habitateve, popullatave dhe proceseve ekologjike në këto zona;
- b. Copëzim dhe fragmentarizim të një numri të lartë të ZM-ve me pasojë humbjen e integritetit gjeografik e ekologjik të tyre;
- c. ;
- d. Rrezikim të habitateve dhe specieve të mbrojtura në nivel vendi, nivel europian dhe global;
- e. Rrezikim të zonave Ramsar, Zonave të Rëndësishme për Shpendët, Zonave Kyçe të Biodiversitetit, Zonave Kandidate Emerald dhe Zonave pilot Natura 2000;
- f. Lënie pa mbrojtje e habitateve bujqësore dhe për pasojë të specieve të mbrojtura dhe të rrezikuara në shkallë lokale, europiane dhe globale me pasojë përkeqësimin e popullatave të tyre;
- g. Vendosjen e zonave qëndrore të çdo ZM-je nën presionin e aktiviteteve ekonomike të paqëndrueshme, sikurse është urbanizimi, industrializimi, infrastruktura e transportit dhe bujqësia intensive;
- h. Krijimin e precedentit të rrezikshëm, që sa herë të ketë interesa ekonomike të paqëndrueshme, ZM-të do të tkurren për t’i lënë vend këtyre zhvillimeve të paqëndrueshme dhe me pasoja të rënda mbi larminë biologjike të vendit.

Po kështu, gjegjësi rasti të ritheksojmë se vetë procesi i rivlerësimit të ndjekur deri më sot, është jo konform legjislacionit në fuqi. Duke i kujtuar Ministrisë se shpallja e ZM-ve, heqja e tyre dhe ndryshimi i sipërfaqes së ZM-ve, duhet të paraprihet nga hartimi i Planit Specifik të tërësisë së zonave të mbrojtura, ne kërkohet që të fillojë puna menjëherë me hartimin dhe miratimin

në rradhë të parë të këtij plani. Vetëm pas këtij hapi, mund të realizohet studimi për rivlerësimin i cili duhet të marrë kohën e duhur dhe jo të kryhet me nxitim sikurse deri më tani. Po kështu, ne i kërkojmë Ministrisë të mos propozojë asnjë ndryshim në rrejtin aktual të Zonave të Mbrojtura qofshin këto shpallje zonash të reja, heqje zonash ekzistuese apo ndryshim të kufijve a te4 statusit të ZM-ve pa studime të detajuara dhe pa argumentet e duhura për secilën zonë specifikisht.

Së fundi, ne, 48 organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të insititucioneve kërkimore-mësimore të vendit, konkludojmë se takimi i zhvilluar në datë 28.07.2021 është në kundërshtim me të gjithë kuadrin ligjor dhe nuk kishte aspak për synim që të ishte një konsultim efektiv për të bërë ndryshime të nevojshme në Draft Vendimet e Këshillit të Ministrave.

Vec kësaj, ky takim paraprihet nga vendimmarrja e Këshillit Kombëtar të Territorit më 28 dhjetor 2020, në një periudhë aspak të përshtatshme për konsultime publike apo me ekspertë, kur vëmendja e aktorëve të interesuar është mjaft e ulët, për shkak të festave të fundvitit. Pikërisht në këtë datë, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar hartat e të gjitha zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë 4 zonat e reja, 6 zonat që hiqen nga sistemi dhe ndryshimet në kategori, apo sipërfaqe të zonave të tjera. Konsultimi për këtë vendimmarrje të prishme duhet të ishte kryer përpara miratimit të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit, pasi pas miratimit VKM-të do të synojnë vetëm zbardhjen e hartave të miratuara tashmë nga KKT të cilat janë harta të miratuara në mungesë të plotë të transparencës dhe të publikuara në faqen zyrtare të KKT-së vetëm tre muaj pas miratimit dhe jo pas 10 ditësh sipas parashikimeve të ligjit.

Ky proces i ri i miratimit të VKM-ve, i nisur sërish në një periudhë të papërshtatshme, për shkak të pushimeve të verës, nuk bën gjë tjetër, vetëm se forcon bindjen tonë që rezultatet e këtij procesi janë të paravendosura prej vitesh dhe synimi është cënimi i sistemit të zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë në interes të përfitimeve ekonomike. Për këtë ne kërkojmë që i gjithë procesi jo vetëm të rishikohet, por të rifillojë nga e para në respektim të dispozitave ligjore, duke garantuar mbrojtjen maksimale të zonave të mbrojtura.

Në rast Ministria nuk ndjek këtë qasje, me shumë keqardhje, ne, 48 organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të insititucioneve kërkimore-mësimore të vendit, **shprehemi se do ta cilësojmë çdo proces jo të ligjshëm dhe nuk do ta pranojmë.** Qasja e deri tanishme për shpalljen, heqjen dhe ndryshimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura, është shumë e gabuar dhe pasojat do të jenë fatale mbi sistemin e Zonave të Mbrojtura dhe larminë biologjike në Shqipëri. Prej këtu do të lindë dhe e drejta jonë **për ta ankimuar këtë proces si nga ana procedurale dhe përmbajtësore.**

Sinqerisht:

## Lista e nënshkruesëve

1. Agjencia e Demokracisë Vendore Shqipëri (LDA Albania )
2. Albanian National, Professional, Business women and Crafts' Association (SHGPAZ)
3. Albanian Ornithological Society (AOS)
4. Birds of Albania
5. Community Reporters Albania

6. FOUR PAWS
7. Grupi ATA
8. Grupimi Mbro Parkun Kombëtar Zall Gjocaj,
9. Help – Hilfe zur Selbsthilfe
10. ILIRIA – Protection and Social & Environmental Development Association, Albania
11. Institute for Environmental Policy, Albania (IEP)
12. Institute for Habitat Development (Co-Plan)
13. Komiteti Shqiptar i Helsinkit
14. Lëvizja për Zhvillimin e Turizmit
15. Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome
16. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV)
17. Milieukontakt Albania
18. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
19. Qendra “Gratë në Shërbim Publik”
20. Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC)
21. Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” Shkodër
22. Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale Kukës (WCSSC)
23. Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare (NCCS)
24. Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER)
25. Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)
26. Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)
27. Qendra për ruajtjen e ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)
28. Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)
29. Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"
30. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)
31. Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes (ACFD)
32. Qendra TREJA
33. Qendra UJA
34. Qendra Vatra
35. Red Tree Heritage Institute Slovenia
36. Resource Environmental Centre, (REC Albania)
37. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)
38. Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive
39. Sustainable Urban Planning Organization
40. Shoqata “Well Point” Kujdes për të gjithë
41. Shoqata “Në dobi të gruas shqiptare”
42. Shoqata GCA
43. Shoqata Gender, Paqe e Siguri
44. Shoqata Unë, Gruaja
45. Shoqata “Together for life”
46. Të bashkuar Pro Kauzës LGBT (Pro LGBT)
47. Women’s Democracy Network Albania (WDN Albania)
48. WWF Adria – Zyra për Shqipërinë

1. Prof. Aleko Miho
2. Prof. As. Mihallaq Qirjo

- 
3. Prof. Ferdinand Bego
  4. Prof. Spase Shumka